

PROCEDURA DHE RREGULLAT PER RREGJISTRIMIN E TE GJITHE STUDENTEVE TE VITEVE

II, III & IV (PT), NE SEZONIN E TE MBARTURAVE 2016-2017

Keto rregulla jane unike per te gjithë studentet e viteve te dyta, te treta dhe te katerta (PT), ne te gjitha ciklet e studimit: BA-KP, BA-PT, MP dhe MSC te cilet jane te regjistruar dhe vazhdojne rregullisht studimet ne vitin akademik 2016-2017.

Per sezonin e te mbarturave 2016-2017 kane te drejte te regjistrohen vetem studentet e vitit te dyte, te trete, dhe te katert (PT), te cilet jane te regjistruar paraprakisht ne vitin akademik 2016-2017 dhe kane provime te mbartura nga viti akademik 2013-2014, 2014-2015 apo 2015-2016.

Theksojme se ne kete sezon keta studente mund te japin vetem provime nga lendet te cilat nuk i kane mare gjate viteve akademike te meparshme 2013-2014, 2014-2015, 2015-2016.

Studentet duhet te regjistrohen vete ne lendet qe do te japin provim. Me poshte tregohet rregullat dhe procedura e regjistrimit.

1. Sezoni i te mbarturave per vitin akademik 2016-2017 eshte: 20 mars - 31 mars 2017.
2. Sa data provimesh do te jene ?.....(3) (27 mars, 29 mars dhe 31 mars)
3. Per nje lende te caktuar sa data provimesh do te lihen ?.....(1)
4. Ne sa provime do te futet studenti ne nje dite ?.....(deri ne 2 provime ne orare te ndryshme)
5. Sa provime mund te jape studenti ne sezonin e te mbarturave?.....(deri ne 3)
6. Studenti mund te prenotohet vetem nje here per te njejtin provim.
7. Per sezonin e te mbarturave rregjistrimi i studenteve per provime do te perfshije periudhen 20 mars – 26 mars 2017.

Sekretarite mesimore duhet te pergatitin paraprakisht grafiket e provimeve.

8. Pas kesaj date asnje student nuk mund te kryeje veprime per rregjistrime ne provimet e sezonit te te mbarturave 2016-2017.
9. Ne provimet e sezonit te te mbarturave 2016-2017 nuk do te futen studentet qe s'kane paguar.
10. Kujtojme se per tu regjistruar ne sezonin e te mbarturave, te gjithë studentet duhet te jene te pasjitur me te dhenat qe ata kane vendosur vete per te hyre ne sistemin e digjital.
11. N.q.s studentet kane problem me keto te dhena atehere te komunikojne sa me shpejt me sekretarite mesimore te fakultetit perkates per tu njohur me to.
12. Menyra e regjistrimit ne provimet e sezonit te te mbarturave 2016-2017 eshte njesoj sikurse dhe ajo e sezonit te vjeshtes 2015-2016 (online).
13. Ne sezonin e te mbarturave pedagogu qe merr studentet ne provim, eshte ai qe eshte percaktuar ne kurrikulen e studimeve te atij viti akademik (2016-2017) dhe jo pedagogu i vitit te kaluar.
14. Per te gjithë studentet te cilet duan te japin ne sezonin e te mbarturave 2016-2017 lende te cilat i kane patur te pafrekuentura gjate vitit akademik 2013-2014, 2014-2015, 2015-2016 por i kane frekuentuar gjate sem I, te vitit akademik 2016-2017 duhet :

a. Te kerkojne nga pedagogu i lendes qe para sezonit, vendosjen e frekuentimit te lendes ne sistemin dixhital te vleresimit. Ne te kundert studenti nuk do te mund te prenotohet nga websiti i tij ne provimin e kesaj lende per kete sezon.

b. Studenti shkon ne websitin e tij dhe regjistrohet, ose kur data e regjistrimit ka kaluar por provimi ende nuk eshte zhvilluar, pedagogu (nese e sheh te mundshme) mund ta shtoje studentin ne procesverbalin e provimit pasi ka verifikuar me pare ne sekretarine mesimore nese ai ka shlyer pagesat.

Kujdes**. Pas dates se provimit studentet nuk mund te regjistrohen per provim ne kete sezon.**